



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:920168
Datë: 22.06.2021
Numri i dokumentit: 01910060

Ae.nr.257/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar kolegji, Liridon Maloku dhe Rustem Thaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arsim Zuka, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“S...”] sh.a., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [A.N] nga Prishtina, Për shkak të pagesës së detyrimit nga Garancioni, në shumën e përgjithshme prej 5,817.79€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, V.Ek.nr.537/2016, të datës 10.05.2019, me datë 14.06.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Qeveria e Republikës së Kosovës –Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës , me seli në Prishtinë dhe të paditurës Kompania e Sigurimeve [“S...”] sh.a., me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, V.Ek.nr.537/2016, të datës 10.05.2019, me datë 14.06.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar në piken I të dispozitivit të aktgjykimimit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme –Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“S...”] sh.a., me seli në Prishtinë, që në emër të ekzekutimit të garancionit paditëses t’ia paguaj shumën e mjeteve në lartësi prej 5,817.79€ me kamate në lartësi prej 8% në vit e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë në gjykate datë 08.11.2016, e deri në pagesën definitive, që të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimimit nën kërcënim të përmbarimit me dhune. Ndërsa në

piken II të dispozitivit e ka refuzuar pjesërisht si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [”S...”] sh.a., me seli në Prishtinë, për ekzekutim të garancionit dhe atë mbi shumën e miratuar të kërkesëpadisë në shumën e mjeteve në lartësi prej 91,631.97€.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit Aktgjykimin e goditur ta ndryshojë duke vendosur meritonisht ashtu që të aprovet kërkesëpadia e paditësit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës në tërësi si të bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Kompania e Sigurimeve [”S...”] sh.a., me seli në Prishtinë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit Aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshojë ashtu që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses në tërësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, me datën 07.11.2016, ka paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [”S...”] sh.a., me seli në Prishtinë, për shkak të kthimit të mjeteve. Në padi nder të tjera ka theksuar se ka qenë në raport kontraktues me [”B...”] për ndërtimin e Objektivit për Shërbime Administrative dhe Mbështetëse të policisë së Kosovës në çmimin prej 974,497.60€, e ku përgjegjës për ekzekutimin e kontratës nga kontraktuesi e ka marrë pala e paditur, përmes lëshimit të policisë së sigurimit dhe se kontraktuesi ka bërë shkelje të klauzolave të kontratës, duke mos e bërë riparimin e defekteve të shfaqura në objekt, e me këtë duke i shkaktuar dëm të konsiderueshëm Policisë së Kosovës. Po ashtu pala paditëse ka shtuar se duke pasur parasysh faktin se defektet në objekt janë shkaktuar gjatë periudhës siguroese ka bërë kërkesë pranë të paditurës si garantuese për konfiskimin e garancionit në vlerën prej 97,449.76€ për shkak të mos përmbushjes së kontratës nga autoriteti kontraktues, mirëpo e paditura e ka konsideruar si jo objektiv raportin e konstatimit të punimeve të pa përfunduara. I ka propozuar gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë dhe ta detyrojë të paditurën që t’ia paguaj shumën e mjeteve në lartësi prej 97,449.76€.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, ngase është vërtetuar se paditësja dhe kontraktori [”B...”] kanë qenë në raport juridike kontraktues dhe atë në bazë të kontratës me numër ... për ndërtimin e objektivit për shërbime administrative dhe mbështetje të Policisë së Kosovës, ku e

paditura ka marrë për detyrim kryerjen e punëve ndërtimore, ndërsa paditësi ka marrë për detyrim pagimin e çmimit të kontratës. Sipas kontratës çmimi i kontratës ka qenë në shumën prej 974,497.60€. Me qëllim të ekzekutimit të plotë të kontratës pala e paditur ka lëshuar policën e sigurimit në dobi të paditësit si garanci se kontraktuesi ["B..."] do ta përmbush në tërësi detyrimin e tij të marrë me kontratë sipas policës së sigurimit shuma e mbuluar me kontrate të sigurimit ka qenë deri në shumën prej 97,449.76€. Nga shkresat e lëndës e sidomos nga raporti i ekspertizës së ndërtimtarisë edhe asaj të elektroteknikes ka rezultuar se kontraktuesi ["B..."] nuk i ka përmbushur në tërësi detyrimin e tij të marrë me kontratën e lidhur me palën paditëse ngase nuk ka bërë sanimin e disa defekteve të shfaqura brenda periudhës së sigurimit. Nga raporti i ekspertizës së ndërtimtarisë është konstatuar se pala paditëse ka kontraktuar një palë të tretë për sanimin e defekteve të shfaqura në objekt edhe pse këtë detyrim e ka pasur kontraktori ["B..."]. Ndërsa ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë në shumën prej 91,631.97€ duke u bazuar në raportin e ekspertizës së ndërtimtarisë, nga ku ka rezultuar se sanimi i defekteve të shfaqura në objekt ka qenë i barabartë me shumën prej 5,817.79€, dhe se pala kontraktuese ["B..."] ka dështuar në përmbushjen e kontratës deri në këtë shumë.

Andaj, gjykata e shkallës së parë duke u mbështetur në dispozitat e neneve 1087 dhe 1088 të LMD-së, si dhe nenit 143 para.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale përkatësisht nenin ... të LMD-së, për shkak se, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk është kontestuese fakti se në mes të paditësit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë dhe Kompania e Sigurimeve ["S..."] sh.a., me seli në Prishtinë, ka ekzistuar raporti kontraktues në baze të kontratës me numër ... për ndërtimin e objektit për shërbime administrative dhe mbështetje të Policisë së Kosovës ku janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e tyre. Gjithashtu nga shkresat e lëndës, nuk është kontestuese se i padituri e ka lëshuar policën e sigurimit garancionin, me numër 9336 për sigurimin se ["B..."] do ta përmbush në tërësi detyrimin e tij të marrë me kontratë sipas policës së sigurimit. Shuma e mbuluar me kontrate të sigurimit ka qenë deri në shumën prej 97,449.76€. Polisa e sigurimit Garancioni me kërkesë të parë me numër të Prokurimit ... të datës 09.11.2015, është lidhur në mes Kompania e Sigurimeve ["S..."] sh.a., dhe ["B..."] në kohëzgjatje prej datës 10.11.2015 deri me datën 09.02.2016. Nga Garancioni me kërkesë të parë është theksuar se pagesa në shumën e limituar prej 97,0449.76€, do të behet pa asnjë kundërshtim as ankesë.

Nga Garancioni rrjedh se e paditura në cilësinë e Garantuesit, ka marrë përsipër se ["B..."] do ta përmbush në tërësi detyrimin e tij të marrë me kontratë sipas policës së sigurimit, sipas kontratës me numër ... për ndërtimin e objektit për shërbime administrative dhe mbështetje të Policisë së Kosovës ku janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e tyre. Garancioni përmban klauzolën sipas të cilës garantuesi merr përsipër për mbulimin e shumës deri në 97,449.76€, me "*kërkesën tuaj të parë*" në rastet e dështimit të Operatorit Ekonomik ["B..."] në përmbushjen e detyrimeve kontraktuese. Meqenëse në këtë raste kontraktuesi ka dështuar në përmbushjen e kontratës, gjë për të cilën është lëshuar garancioni, kjo gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejta ka vepruar kur ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit pjesërisht duke e detyruar paditësin t'ia kompensojë shumën prej 5,817.79€, ngase duke u mbështetur në shkresat e lëndës e sidomos raporteve të ekspertizave të kryera, rezulton se vlera e dëmit të shkaktuar, gjegjësisht vlera e defekteve të cilat nuk kanë sanuar nga kontraktori ["B..."] është në shumën prej 5,817.97€, andaj paditësi me të drejtë ka kërkuar ekzekutimin e garancisë.

Sipas Nenit 262 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve kreditori në marrëdhëniet detyimore ka të drejtë që nga "*debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mos-përmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi*", prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura me mospagimin e garancisë i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, ka refuzuar ankesat e palëve dhe ka vendosur si në dispozitiv.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur edhe në pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit të atakuar, kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për pagesën e shumës mbi shumën e aprovuar, sepse nga ekspertiza rezulton se dëmi i pësuar nga paditësi për shkak të mospërmbushjes së plotë të detyrimeve kontraktuese respektivisht sanimit të defekteve të shfaqura në objekt është në shumën prej 5,817.79€, ndërsa garancioni ka për qëllim mbulimin e dëmeve që mund të rrjedhin nga mospërmbushja e kontratës së siguruar, e jo përfitimi nga dështimi i palës tjetër, andaj me të drejtë gjykatat e shkallës së parë ka aprovuar kërkesën për ekzekutimin e garancionit në mënyrë propocionale me dëmin e pësuar.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditëses, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara dhe në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës, sepse të njëjtat pretendime janë ngritur edhe para gjykatës së shkallës së parë, por gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të ligjin material, dhe për të gjitha çështjet kontestuese ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse, me të cilat pajtohet plotësisht edhe Gjykata e Apelit.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të së paditurës, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të ligjin material, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe pa asnjë mbështetje ligjore.

Numri i lëndës: 2020:920168
Datë: 22.06.2021
Numri i dokumentit: 01910060

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,
Ae.nr.257/2019,dt.14.06.2021

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli,d.v.

